




Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12.060/2019-66641 dt. 15.11 2019

Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
30.10.2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 30.10.2019

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 27 anëtarë .

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 26 .09.2019.
2. Propozim Vendim për miratimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE – së) 2019 – 2021.
3. Raporti financiar i zhvillimit të Buxhetit janar - shtator 2019.
4. Vendim për plotësimin e ndryshimin e Rregullores Komunale për Transparencë.
5. Vendim për bartjen dhe transferim të mjeteve.
6. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 30 /10/ 2019 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Nënkryetari i Komunës Nazmi Hasi, Kryesuesi Labinot Halilaj, përfaqësues të OSCE-së,KDI - së si dhe drejtor të Drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- Ju përshëndes të gjithë, hapi diskutimin për rendin e ditës dhe kërkoj nga anëtarët e kuvendit se a pajtohen me këtë rend dite, apo ka ndonjë propozim? Në rendin e ditës janë shtuar edhe dy pika; Propozim ndryshimi për plotësimin dhe

ndryshimin e Rregullores Komunale për Transparencë, me kërkesë të MAPL-së pasi nuk e kemi një nen, që faktikisht nuk egziston akoma, por na kanë rekomanduar për ta implementuar edhe këtë në rregullore dhe me e votu edhe njëherë nga Kuvendi. Si dhe Vendim për bartjen dhe transferim të mjeteve. Atëherë nëse nuk ka ndonjë mendim kalojmë në votim për të shkuar me këtë rend dite dhe me dy pikat e propozuara.

Për votuan 26 anëtar, Kundër s'ka, Abstenim 3 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; Ju faleminderit kalojmë për miratim të pikës 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 26.09.2019. Pasi nuk ka diskutime, vërejtje apo sugjerime kalojmë në votim.

Për votuan 28 anëtar, Kundër s'ka, Abstenim s'ka votohet. Kalojmë tek pika

2. Propozim Vendim për miratimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE – së) 2019 – 2021. Fjala për Vehbi Berisha

Vehbi Berisha; Unë nuk e kam këtë material . Kam pyetur edhe kolegë dhe po ashtu ata nuk e kanë. Më vjen keq por kjo është jashtë parimeve të mia për të votuar qorrazi pa e pasur materialin, draftin ose planin.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj – Më falni a e ka ndokush materialin. Nëse është problem teknik unë ju kërkoj falje dhe jua dërgoj materialin. Ne jemi marrë vesh për shumë probleme e jo mandej për çështje teknike. Po zoti Kiçina

Beqir Kiçina; Nuk është faji juaj, as tek administrata e Kuvendit, por Kuvendi duhet ti bë një pyetje ministrisë përkatëse pasi ata e kanë databazën e e-mailave. Nuk është se e kemi harruar pasurdin por nuk funksionojnë. Për shumicën e assambleistave nuk u hapen adresat e e-maileve.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; Atëhere materialet po ua dërgoj dhe fjalën në pika të shkurtra po ia jap drejtoreshës.

Drejtoresha Lumnije Krap; Plani i veprimit të eficiencës të energjisë në komunën e Drenasit është një dokument që analizon situatën aktuale të energjisë dhe rekomandon, veprimet dhe ndryshimet që duhet të ndërmerren në të ardhmen në sektorë të ndryshëm të shërbimeve komunale, në lidhje me konsumimin e energjisë elektrike. Domethënë në këtë dokument janë të analizuar dhe përfshirë të gjitha ndryshimet që duhet të ndërmerren për të rritur eficiencën e shfrytëzimi dhe përdorimit të energjisë. Si objektivi në këtë plan komunal të energjisë të eficiencës është zvogëlimi i energjisë në objektet e ndryshme komunale si dhe në ndriçimin e rrugëve. Në Drejtoratin e shërbimeve publike është instaluar softueri ku janë hedhur të gjitha të dhënat për shpenzimet e energjisë duke filluar nga viti 2007 – 2018, ku çdo vit i fusim të dhënat për konsumimin e energjisë, ku janë të përfshira të gjitha objektet e shkollave, objekti i

admintratës komunale, qendrat shëndetësore si dhe ndriçimi i rrugëve. Kemi një marrëveshje me KEDSIN për qasjen rreth faturave të konsumimit të energjisë, p.sh nëse bëhet ndonjë ndryshim tek faturat e vërejmë sepse kemi qasje direkte. Domethënë për çdo riparim apo ndryshim që ndodh në shkolla mund të bëjmë përditësimin e të dhënave.

Duke u mbështetur në nenin 6 të ligjit 06/L- 79 për eficientësin e energjisë, të gjitha komunat janë të obliguara ta kenë këtë plan të emplementimit komunal të eficientësisë për energji.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; E hapim për diskutim. S'ka atëherë kalojmë në votim;

Për votuan 23 anëtar, Abstenim 6 anëtar, Kundër s'ka. Kalojmë në pikën

3. Raporti financiar i zhvillimit të Buxhetit janar - shtator 2019. Ka diskutime? Po zoti Berisha.

Vehbi Berisha; Në fakt nuk e kam për diskutim por më shumë kam pyetje që lidhet me raportin e buxhetit për këtë periudhë kohore. Tek tabela nr2 nëse krahasojmë shifrat e të hyrave nga disa kalkulime që kam bërë sikur nuk më dalin ashtu si në raport, sepse kur analizojmë në total më del sikur kemi më pak të hyra rreth 14 000 euro pak se në vitin 2018, p.sh tek tabela 5, tabela 6. Tek konkluzioni në fund del se parametrat e performacës për shpenzimet publike janë realizuar. Për mua performanca duhet trajtuar në përgjithësi, si shuma e të hyrave në total edhe pse ka trend në rritje të performancës për shpenzimet e parasë publike. Duke qenë ithtar i asaj që një raport buxhetor duhet tregojë qartë të gjitha të dhënat të planit financiar mua po më duket e paqartë.

Kryetari i Kuvendit Ramiz Lladrovc- Ndryshimi ka ardhur sepse në vitin 2018 nga kemi marrë nëpërmjet përmbaruesit 300 000 euro nga Parku i Biznesit, kurse sivjet inkasomi është 160 000 euro prandaj duket ky ndryshim.

Drejtori për buxhet Shyqiri Bublaku vijoi me sqarimin e nevojshëm, me shifra, për pyetjen pse kanë ndodhur ky ndryshim.

Petrit Sinani; Ajo që me intereson është ajo që në muajin prill realizimin e vitit 2019 e kemi 326 539 euro. Raporti duket sikur është kundërtëhënës. Në rast se themi se nuk i kemi 326 539 të realizuara por themi 59 000, atëherë kjo i bie që këto janë të vitit 2018. Në rast se i kemi të realizuara në periudhën janar-qershor 382 000 atëherë është në rregull. E dyta në momentin kur bëhet një raport financiar dhe shënohet realizimi i vijës së shpenzimit të buxhetit komunal sipas programeve dhe nën programeve për periudhë janar qershor 2019, nuk është e arsyeshme kur ti thua se realizimi për periudhën janar qershor 2019 dhe bën krahasim me periudhën në vitin 2018. Ti nuk ke të drejtë se nuk ke hap bazë që po bën krahasim. Tjetra pagesa shpenzime, terminologjia pagesa dhe terminologjia shpenzime dallojnë. Pagesa është e marr, shpenzimi është e dalur. Domethënë a është pagesë a është shpenzim se na duhet me ditë këto terme se janë shpenzim apo pagesë. Pra këto janë dy terma të ndryshme që dallojnë njëra me tjetrën. Tjetra, kur thuhet përqindja realizim alokim, përqindja në buxhet për vitin 2018 a janë për vitin 2019 a

është përqindje me plan sepse janë tabela dhe po përpiqem me i lexu e s'po mundem, sepse nuk ka kuptim realizim 550 – 600% a kupton.

Drejtori Shyqyri Bublaku; I kemi grantet e performancës që e kemi shumën 326 000. Këto i kemi me punën tonë nuk janë të hyrat që na i ka paraqit pagesë ose shpenzim, dmth e kam bërë pagesën e këtij shpenzimi pra pagesa është shpenzim.

Pagesa – shpenzime është term që përdoret në ekonomi nuk është që e kemi shpikur ne.

Sokol Bylykbashi; Kur kemi kësi raporte financiare buxheti, duhet të flasim për kategoritë e shpenzimeve, ku fokusi është tek shpenzimet kapitale mund të ndryshojë varësisht prej drejtorive. Nëse flasim për investime kapitale, fokusi është këtu. Unë po ndalem tek tabela për investime kapitale në Drejtorinë e Infrastrukturës tabela nr.9 tek investimet kapitale. Pra kemi ndarje të buxhetit 3 592 000 euro, ndërsa deri në muajin shtator janë shpenzuar 1 264 000. Kemi një suficit prej 2 328 000 Nëse koha është e mirë ndoshta mund të punohet edhe në nëntor, nuk e di kjo është edhe punë fati. Unë e kam fjalën se për këtë periudhe është një shifër goxha e madhe për tu realizuar.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovc; Sokol vitin e kaluar e kemi pasur njëzet e diçka për qind në këtë kohë pagesat për investime kapitale. Ju e dini që deri në mars nuk mund të kryejmë asnjë lloj pagese edhe për ato punë që mbesin nga viti paraprak. Pastaj janë tenderimet. Ne ala jemi në proces tenderimesh dhe presim me krye dhe me e realizu buxhetin të paktën mbi 75% nëpërmjet granteve.

Nexhmedin Balaj; Unë mendoj se ky raport financiar është shumë i saktë i plotësuar edhe me tabela dhe pasqyron realisht mënyrën se si janë shpenzuar e sa janë shpenzuar mjetet financiare gjatë kësaj periudhe nëntëmuajore. Mendoj se është me shumë vend krahasimi me vitin 2018 me duket i saktë sepse i paraqet më mirë performancën e të hyrave vetanake dhe ajo e granteve 247 439 që tregon për një performancë të mirë për komunën tonë.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; A ka diçka tjetër s'ka, ky raport nuk votohet kalojmë në pikën tjetër; **Vendim për plotësimin e ndryshimin e Rregullores Komunale për Transparencë.** Meqë është e detyrueshme kalojmë në votim. **Votojmë; Për votuan 30, Abstenim s'ka, Kundër s'ka, votohet.**

Kalojmë për diskutim në pikën, **5. Vendim për bartjen dhe transferim të mjeteve.** Ka diskutime? Po

Petrit Gashi Faktikisht pse jemi bërë humor i disa vendimeve kjo është e vërtetë jo vetëm me këtë vendim por edhe me shumë të tjera. Saktësisht para një viti e një muaj kemi atakuar Drejtorinë e Arsimit për mungesë buxheti dhe mbylljen e nja tri shkollave. Madje njëra shkollë 112 nxënës për shkak të mungesës së buxhetit. Sot pas një viti e një muaj po del se pikërisht Drejtoria e Arsimit paska pasur buxhet boll dhe duhet atë buxhet ta shpiem tjetër kund. Pra kryetar nxënësit i këna lënë rrugëve, mësimdhënësit i kena heq, objektet janë demolu dhe të

gjitha ato pare të qytetarëve të Drenasit po shkojnë poshtë dhe sot po na del se këtë buxhet të Drejtorisë së arsimit duhet të bartet diku tjetër. Është pikërisht kjo që nuk e mbështes këtë vendim duke u deklaruar kundër.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci; Zoti Gashi bash kurrë nuk ke thënë, bash hiç. As nuk jam tu bart buxhet të arsimit, as nuk jam tu mbart ... për shkolla, as nuk kam mshelë shkolla, por kam mshle paralele shkolla kom funksionu dhe u kom spjegu; Nuk kam buxhet për mësim dhënës jashtë listave të pagave të parapara me ligj, kaq. As nuk kam dashtë me e hedh topin tek asamblea, por u kam thënë: A keni asi informacionesh pse nuk po më çoni në prokurori, por vetëm sa me fol diçka. Faktet janë në krahun tim sepse nuk kam hequr as një cent nga buxheti për arsim, por vetëm kam ndalur mësuesit që nuk janë në listën e pagave. Unë nuk mbaj mësues mbi numrin e listës të parashikuar me buxhet se nesër apo pas 20 vjetësh edhe mua më thotë dikush; pse i ke paguar?

Debatet vijuan me sqarime nga drejtori i Buxhetit Shyqyri Bublaku dhe herë pas here nga Kryetari i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Labiriot Halilaj; Atëherë a ka diskutime të tjera? Jo. Kalojmë në votim. Votojmë tani; *Për votuan 18, Abstenim 7, Kundër 2. Votohet.*
Kalojmë në pikën e fundit; 6. Të ndryshme.

Lidhur me këtë pikë, Të ndryshme, nuk ka votim por thjesht probleme të lira nga tereni për tu ngritur dhe debatuar. Asambleistët trajtuan probleme të ndryshme duke shprehur kërkesat e qytetarëve të cilat u zhvilluan me debate sqaruese nga drejtorët përkatës dhe kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci.

Pas fjalës së kryetarit Kryesuesi deklaroi mbylljen e punimeve të seancës.

Mbledhja përfundoi në orën 12⁰⁰:51⁰⁰

Procesmbajtëse:

Zahrie Podrimqaku-Subashi



Kryesuesi i Kuvendit
Labiriot Halilaj